

VENDIM
Nr. 348, datë 13.5.2026

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR PRIVAT TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË “KRYQI I
NDERUAR”, GJIROKASTËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat të arsimit të mesëm të lartë “Kryqi i Nderuar”, Gjirokastrë, në të cilin zhvillohen edhe lëndë fetare, të cilit i është dhënë leje funksionimi me vendimin nr. 279, datë 10.6.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënie leje funksionimi të institucionit arsimor jopublik”.

2. Institucioni arsimor parauniversitar privat i arsimit të mesëm të lartë “Kryqi i Nderuar”, Gjirokastrë, ka këto detyrime:

a) Të pajisë çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar;

b) Të mbulojë të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij vendimi;

c) Të kthejë pagesat e kryera (nëse ka) nga prindi/përfaqësuesi ligjor i nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbytur, që mund të ketë ndaj nxënësit;

ç) Të vërë në dispozicion të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë vendim;

d) Të dorëzojë në Arkivin Shtetëror Vendor të gjithë dokumentacionin që disponon, si dhe të paraqesë në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, një kopje të dokumentacionit e të procesverbalit të dorëzimit të tij, sipas afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

3. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit ndodhet shkolla, ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune, brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat të arsimit të mesëm të lartë “Kryqi i Nderuar”, Gjirokastrë;

b) të marrë masat për transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të gjithë nxënësit e regjistruar në këtë institucion arsimor;

c) të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar privat.

4. Vendimi nr. 279, datë 10.6.1999, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënie leje funksionimi të institucionit arsimor jopublik”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Gjirokastrë-Libohovë, institucioni arsimor parauniversitar privat i arsimit të mesëm të lartë “Kryqi i Nderuar”, Gjirokastrë, dhe Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama